



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 414 prot

Vlorë, më 05/03/2020

VENDIM

Nr 8 datë 26/02/2020

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES OPERACIONALE NDËRMJET
MINISTRISË SË EUROPËS DHE PUNËT E JASHTME DHE KËSHILLIT TË
QARKUT VLORË**

Këshilli i Qarku Vlorë, i mbledhur sot më atën e sipër-shënuar, në zbatim të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 137, dt. 22.12.2016 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit Evropian për Programin INTERREG IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020”, Ligjit nr. 37, dt. 9.04.2015 “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të Mbështetjes Financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA II)” dhe VKM Nr. 541, datë 18.6.2015 “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së bashkimit evropian, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit IPA II (2014 – 2020)”, pasi mori në shqyrtim Marrëveshjen Operacionale ndërmjet Ministrisë së Europës dhe Punët e Jashtme dhe Këshillit të Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

- 1) Të miratojë Marrëveshjen Operacionale ndërmjet Ministrisë së Europës dhe Punët e Jashtme dhe Këshillit të Qarkut Vlorë për detyrat dhe përgjegjësitë për zbatimin e projektit GET të financuar nga programi INTERREG IPA i bashkëpunimit Ndërkufitar Greqi-Shqipëri 2014-2020.
- 2) Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut, Kabineti dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve.
- 3) Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 78, pika 3.

Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlore me shkresën me nr. _____ prot. dt. ____/____/____